

**Takim pune i ekipit menaxhues të projektit në kuadër të Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) për “zvogëlim të pagesave në para të gatshme në Kosovë”**

Procesverbali i mbledhjes

**Ref. 8/2012**

**Vendi:** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

**Data:** 19 Shtator 2012

**Koha:** 11:00 – 12:20

**Pjesëmarrësit:**

**Robert Wright**, *Shef Kryesor Ekzekutiv, RBKO (kryesues);*  
**Gjylfidane Kadrijaj**, *Drejtores e Departamentit të Sistemit të Pagesave, BQK;*  
**Cyril Ghanem**, *MasterCard;*  
**Golnaz Amininejad**, *MasterCard;*  
**Boryana Ivanova Mustafa**, *Drejtores e Pagesave dhe Thesarit, NLB ;*  
**Akile Cernobregu**, *Drejtores e Departamentit të Pagesave, PCB*  
**Ozenc Alkan Asik**, *Udhëheqëse e Operacioneve Bankare, TEB*  
**Edmond Jashari**, *TEB;*  
**Edmond Murati**, *MPMS;*  
**Naim Gashi**, *Menaxher i Thesarit, PTK*  
**Ragip Zogiani**, *Menaxher i Zhvillimit të Shërbimeve dhe Rrjetit Postar, Posta sh.a.*  
**Xhevat Zejnullahu**, *Zëvendës drejtor i Thesarit, MF*  
**Rifat Hyseni**, *Drejtor, Departamenti i TI, ATK*  
**Mentor Mikullovc**, *NLB;*  
**Fatmir Rashica**, *Specialist për Kontroll të Pagesës, KEK;*  
**Hikmete Mataj**, *KEK*  
**Blerta Krasniqi**, *PCB;*  
**Afrim Gërguri**, *PCB;*  
**Suzana Shehu**, *Udhëheqëse e Sektorit të Pagesave, BPB;*  
**Ardian Doku**, *BPB*  
**Burim Kabashi**, *Koordinator për Kartela Bankare, BEK;*  
**Lindita Mehmeti**, *Udhëheqëse e Departamentit të Operimeve dhe Thesarit, BEK*  
**Ardian Efendija**, *BKT,*  
**Shpend Maxhera**, *TEB,*  
**Orcun Ozdemir**, *Udhëheqës i Departamentit të Kartelave, TEB*  
**Roza Gojani**, *BQK;*  
**Igballe Agushi**, *BQK;*  
**Qëndresa Krasniqi**, *BQK;*  
**Masar Baxhaku**, *BQK;*

Munguan:

**Përfaqësuesit e “KUR Prishtina sh.a.”** (munguan pa njoftim paraprak) .

Takimi filloi në ora 11:00.

Znj. Gjylfidane Kadrijaj hapi takimin, përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje dhe njoftoi për praninë e përfaqësuesve të kompanisë MasterCard në këtë takim Znj. Golnaz Amininejad dhe Z. Cyril Ghanem.

Z. Robert Wright falënderoi përfaqësuesit e MasterCard për ardhjen e tyre në takim, gjithashtu njoftoi të pranishmit me agjendën e takimit dhe kërkoi nga ta që nga takimi i ardhshëm pjesëmarrës të jenë vetëm anëtarët e grupit punues me qëllim që të arrihet qëndrueshmëri dhe mirëkuptim i përbashkët.

### **Diskutimet dhe prezantimet**

- **Miratimi i procesit dhe konkluzioneve të takimit të fundit**

Nga të pranishmit u miratuan procesverbali dhe konkluzionet nga takimi i fundit i mbajtur më 26 Qershor 2012. Po ashtu Z. Robert Wright informoi të pranishmit me konkluzionet nga takimi i fundit i Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) mbajtur më 5 Shtator 2012

- **Prezantim nga ana e përfaqësuesve të MasterCard**

Përfaqësuesit e MasterCard, Znj. Golnaz Amininejad dhe Z. Cyril Ghanem fillimisht bënë një prezantim të shkurtër të aktivitetit të kompanisë MasterCard. Aktiviteti i MasterCard është i shtrirë në tri fusha kryesore:

- Franshiza- MasterCard përkrah afër 25 000 lëshues të kartelave që mbështesin dhe bëjnë shitjen e kartelave të tilla duke hapur dyert për tregti në miliona lokacione të tregtarëve në mbarë botën;
- Procesimi- rrjeti i teknologjisë shumë të avancuar në MasterCard mundëson kryerjen e transaksioneve në shkallë globale;
- Këshillimi- MasterCard ofron njohuri operationale dhe strategjike dhe zgjidhje që e avancojnë tregtinë

MasterCard është e vetëdijshme se niveli i lartë i transaksioneve me para të gatshme shkakton shqetësime të gjitha palët e kyçura në sistem të pagesave në Kosovë (shërbimet publike, bankat komerciale, Banka Qendrore). Këto shqetësime janë të lidhura me shpenzimet lidhur me trajtimin e parave Cash si dhe jo efikasitetin e shkaktuar nga niveli i lartë i mospërdorimit të formave tjera të pagesave.

Në mënyrë që të zvogëlojë pagesat me para të gatshme në Kosovë, Qeveria ka fuqinë për të ndërmar disa nisma ligjore dhe administrative (ndryshime në ligj) dhe për të shpërndarë kartela për të gjithë qytetarët në vend.

Qëllimi kryesor i kësaj rregulloreje do të ishte:

- Reduktimi i transaksioneve Cash, duke krijuar barriera për përdorim të mjeteve Cash; kombinuar me
- Rritjen e transaksioneve jo Cash duke krijuar stimuj për konsumatorët dhe tregtarët që përdorin kartela, si zgjidhje alternative ndaj Cash-it.

*Për më shumë detaje keni të bashkangjitur prezantimin nga MasterCard.*

### **Konkluzionet e Takimit dhe Hapat e ardhshëm**

- Të përgatitet një analizë detale për ecurinë e pagesave KOS GIRO për takimin e radhës (BQK);
- Statistika detale për numrin e terminaleve ATM dhe POS (aktiv dhe pasiv) dhe për takimin e radhës të përgatiten statistika dhe analiza për instrumentet e pagesave në Kosovë (BQK);
- Të kërkohen të dhëna statistikore shtesë nga bankat nëse këto të dhëna nuk janë të përfshira në “metodologjinë për raportimin e instrumenteve të pagesave”, me qëllim që statistikat dhe analizat të jenë më cilësore (bankat komerciale dhe BQK);
- Në takimin e ardhshëm ekipa të diskutojë lidhur me projektin për të cilin mund të kërkojë mbështetje nga ana e MasterCard.